



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes urgjente të Komitetit për Politikës dhe Financa, e mbajtur më
02.05.2018, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Genc Sherifi, Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Fadil Gashi dhe Sami Boroci.

Munguan: Visare Gashi dhe Blerand Stavileci.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, dhe Admir Shala nga INPO.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kuleta, kryesues.

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se kjo mbledhje është thirrur vetëm për një pikë të rendit të ditës.

RENDI I DITËS:

1. Propozivendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe të NATO-së.

Osman Bllaca tha se sa i përket këtij propozimvendimi, ka qenë takim i Kryetarit me përfaqësues të KFOR-it për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe të NATO-së, dhe është propozuar të jetë në sheshin "Nënë Tereza".

Halim Halimi u shpreh në përkrahje të këtij propozimvendimi.

Fadil Gashi pyeti lidhur me pagesën për këtë mbledhje.

Halim Halimi tha se gjatë një viti nuk mund të paguhet më shumë se 12 mbledhje, e së paku duhet mbajtur 10 mbledhje. Mund të paguhet kjo mbledhje e jashtëzakonshme, por mbi 12 nuk paguhet.



Osman Bllaca dha sqarime, duke cekur se me mbledhjet e KPF-së kemi ngelur prapa, për shkak se për mbledhjen e parë, për zgjedhjen e kryesuesit, nuk mund të mbahet mbledhje e Komitetit për Politikë dhe Financa, por drejtpërdrejt thirret mbledhje e rregullt, thirret mbledhja e dytë e Kuvendit dhe mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Ne me mbledhjen e parë të KPF-së i kemi mbajtur dy mbledhje të Kuvendit dhe jemi dy mbledhje mbrapa, tani me këtë mbledhje jemi vetëm me një mbledhje mbrapa.

Kryesuesi e hodhi në votim Propozimvendimin.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozivendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe të NATO-së dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Kryesuesi sugjeroi që kjo pikë të futet në rend dite për Kuvend, pas pikës së ekstraktit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:10

Procesmbajtësja
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta